



01/Nr. 3693/2024  
Data : 13.05.2024

## PROCESVERBALI I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e katër -IV- për vitin 2024 e Komitetit për Politik dhe financa, mbajtur me datë 22.04.2024 me fillim pune ne ora 13:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetar i Komunës), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Natyra Kalisi** (Drejtoresh e Administratës), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Kimete Kuka - Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Arbenita Bajramaliu** (Drejtoresh për Kulturë Rini dhe Sport), **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), **Sara Berisha** (Asistente e Kryesuesit të Kuvendit), **Bashkim Sopa** (Zyrtarë për Informim), **Rezart Mehmeti** (Përfaqësues i OSB-së).

### RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2024.
3. Informatë për ndarjen e bursave.
4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2024 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.
5. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

## 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Natyra Kalisi** thekson:- kërkoj që në procesverbalin e Komitetit për Politikë dhe Financa që të ndryshohet dhe të pasqyrohen kërkesat e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës duke filluar nga kërkesa për vendosjen dhe mbikëqyrjen e kamerave e sigurisë nga administrata komunale si dhe akuzat ndaj meje në lidhje me projektin e kamerave të sigurisë. Kërkoj që të citohen të gjitha fjalët që kam kërkuar argumente në lidhje me akuzën e tij.

Si drejtoresh a i ke kërkuar kamerat për në Han të Elezit si drejtoreshë e administratës, ke bashkëpunuar ty me policinë për vendosjen e kamerave dhe në atë projekt a duhet me qenë një person adekuat si urë lidhëse në mes të komunës dhe policisë se nëse bëhet ndonjë dëm në komunitet sepse ato kamera janë vendosur për çështje të sigurisë, a duhet dikush me dhënë llogari dhe përgjegjësi nëse të bëhet një dëm dhe duhet me u shikuar ajo kamerë dhe nëse administratorin nuk e merr parasysh policia ty si drejtoreshë a mundesh me shkuar me kërkuar ose me qenë një person adekuat për çështjen e këtyre kamerave.

Kamerat është e vërtetë që vendosen për monitorimin e aspekteve të sigurisë, mirëpo komuna nuk është organ kompetent për vëzhgimin e tyre por është ligji për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale të cilën vetëm policia i ka. Në fillim të mandatit kemi pranuar shkresë ku kanë qenë të kyçura kamerat e qytetit në komunë dhe është kërkuar specifikisht të largohet qasja e kamerave të qytetit brenda objektit të komunës dhe janë larguar se e kemi edhe deklaratën e operatorit i cili e ka barë shkëputjen e këtyre kamerave.

Pse vendosen kamerat në vende që komuniteti e di që ka kamera të sigurisë ku në fakt për ato kamera nuk jep llogari askush. Atëherë pse shpenzohen mjetet financiare kot.

Është policia organ kompetentë dhe nuk mundem me ndërhyjë në polici.

Je drejtoreshë dhe a ke bashkëpunuar me policinë që të ketë ndonjë bashkëpunim në mes komunës dhe policisë për çështjen e kamerave që të monitorohen. Atëherë pse i keni blerë kamerat kur nuk monitorohen, ju leje që i keni blerë por edhe ju kanë tepruar.

Nuk kanë tepruar kamerat dhe a keni fakte i nderuar kryesues. Nuk është mirë si kryesues i kuvendit me i bërë këto paragjykime pa pasur fakte dhe argumente.

Fakte kam për shkak se administratori ka ardhur tek ju për me lajmëruar rastin që është bërë dëmi dhe ju keni thënë se nuk keni qasje në ato kamera dhe administratori ka qenë edhe në polici dhe përgjigje nuk ka pasur për shkak se kanë deklaruar se nuk punojnë kamerat atëherë diçka nuk është në rregull.

Nuk është kompetencë që me u përzier në polici drejtorja e administratës.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR



## 2. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2024.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Lindita Ballazhi** thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit me numër 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin 2024 është në lartësi prej 3,349,278.00 €, ndërsa buxheti përfundimtarë është në shumë 3,811,674.42 €, ku në këtë shumë përfshihen : shuma e ndarë nga Grantet Qeveritare në shumë prej 3,074,901.87 €, projeksioni i të hyrave vetanake komunale në shumë prej 274,376.00 €, donacioni nga Unioni Evropian për projektin dy vjeçar “A smart sistem for Early Floods Detection and Waste Monitoring in the Lepenc River Basin në shumë prej 446,352.85 €. Pjesa e mbetur e donacionit nga Qeveria Japoneze për projektin ‘Ndërtimi i aneksit për për këmbësorë në Urën e Seçishts “ në shumë prej 15,923.01 €. Mjete të mbetura nga grantet të cilat janë bartur vit pas viti në shumë prej 120.69 €. Në kategorinë paga dhe mëditje shpenzimi është në shumë prej 554,498.84 € apo 25.75 %, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 98,504.12 € apo 18.75%, në kategorinë ekonomike shërbime komunale shpenzimi është në shumë prej 17,969.68 € apo 19.22 %, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 6,109.00 € apo 5.41 %, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale shpenzime nuk ka pasur. Totali i shpenzimit për periudhën Janar -Mars të vitit 2024 është në shumë prej 678,081.64 € apo 17.79 %. Projeksioni i të hyrave vetanake për vitin 2024 është në shumë prej 274,376.00 € . Komuna e Hanit të Elezit ka arritur të arkëtojë 111,374.83 € të hyra vetanake për periudhën Janar - Mars 2024 apo 40.5 % e planit të të hyrave vetanake , ndërsa në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2023 kemi një rritje më shumë prej 67,625.54 € apo 87.18 %.

**Sherif Berisha** thekson:- a do të jetë ky raport i njëjtë deri në mbledhje të Kuvendit të Komunës

**Lindita Ballazhi** thekson:- te kategoria mallra dhe shërbime me një vend është kalkuluar petikeshi ndërsa me një vend tjetër nuk është kalkuluar , kjo nuk është gabim se avanci shfaqet normalisht kur përmbillet viti në raportin një vjeçar .

**Hyriete Isufi** thekson:- te të hyrat vetanake shifra 87.18 % a është gabim se në vitin e kaluar është bërë falja sepse tash nuk e di që janë shpërndarë faturat e tatimit në pronë

**Lindita Ballazhi** thekson:- në këtë vit do të ndikojë edhe inkasomi i për shkak të marrjes së vendimit në kuvend komunal për faljen e tatimit në pronë në shumë deri në 100 € , mirëpo tash kemi një inkasim më të madh në krahasim me tre mujorin e vitit të kaluar pasi që edhe projeksioni i të hyrave vetanake në këtë vit është më i ulët se sa në vitin e kaluar.

**Sherif Berisha** thekson:-borxhi i derivateve nga viti i kaluar a është përfshirë në këtë raport

**Lindita Ballazhi** thekson:- në këtë raport nuk kemi të shpalosura obligime të cilat i ka komuna , ndërsa nëse ka mbetur ndonjë borxh nga viti i kaluar pagesa nuk është bërë në muajin janar por në muajin shkurt me siguri. Te kodet ekonomike është shpenzimi për derivate por saktësisht nuk e di për cilat fatura e keni fjalën por në thesar i kemi të deklaruara për çdo muaj obligimet e pa paguara.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U VOTU RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANR-MAR 2024 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**



### 3. Informatë për ndarjen e bursave.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Hisni Luri** thekson:- në bazë të thirrjes të cilën e ka shpallur drejtorja e arsimit për bursa , komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentacionet dhe ka bërë përzgjedhjen e katërdhjetë studentëve të cilët janë përfitues të bursës komunale. Kanë aplikuar 63 studentë e që prej tyre 43 ishin të vitit të dytë e më lartë dhe 20 ishin të vitit parë. Në bazë të rregullores për subvencione përfitues të bursës janë edhe studentët nga Maqedonia e Veriut.

**Hyriete Isufi** thekson:- do të thotë vetëm tre studentë kanë mbetur pa përfituar bursë .

**Hisni Luri** thekson:- këto tre studentë do të financohen prej donacioneve të cilët kanë kërkuar që mos me ua publikuar emrin.

**Kryesuesi** thekson:- a ka pasur ndonjë ankesë .

**Hisni Luri** thekson:- ankesë zyrtare nuk kemi, pa u përfshirë ka mbetur një studentë që studjonë në Universitetin e Tetovë për shkak të pagesave të semestrit që kanë ndryshe prej këtyre në Kosovë por në mesin e këtyre tre studentëve që do të subvencionohen besoj që do të hynë.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U VOTU INFORMATA PËR NDARJEN E BURSAVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

#### 4. Raporti financiar për periudhën Janar – Mars 2024 i N.P.L “Pastrimi” sh.a.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- kemi pasur mungesë të një anëtari të bordit, është shpallur konkursi por ka qenë vetëm një aplikuesë dhe është përzgjedhur.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### U VOTU RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 2024 I NPL PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

#### 5. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sherif Berisha** thekson:- kush e kontrollon parkingun zyrtarë të komunës dhe më intereson të dijë se pse me pasur vetura private që në këtë rast është vetura e nënkryetarit të komunës. Dhe nuk është çështja vetëm e parkimit të veturës por edhe përgjigje tjetër nuk kam marr për pyetjen që kam parashtruar për regjistrimin e tabelave që është bërë ndryshimi prej tabelave zyrtare në tabela civile dhe nuk kam marr përgjigje.

**Natyra Kalisi** thekson:- është përgjegjësi e udhëheqësit të autoparkut por pasi ka qenë një automjeti lirë mundet me parkuar nënkryetari.

**Sevdi Dernjani** thekson:-nëse dikujt i pengon vetura ime nuk është problem mundem me hequr por duni me pasur parasysh që ato parkingje janë zyrtare dhe unë jam nënkryetar i komunës dhe normal me leje të Kryetarit të Komunës është e vendosur edhe vetura ime aty. Unë ta kam dhënë shkresën e Ministrisë që ma ka lejuar si çështje që me legjislacion të lejohet prej tabelave zyrtare me bërë në tabela civile.

**Kryesuesi** thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoj në ora 13:33.

**Procesmbajtësi**  
**Avni Bushi**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Florim Shkreta**

